

Master Profesional në **Menaxhim Informacioni në Agrobiznes** (120 ECTC, 2 vite akademike, me kohë të plotë)

Profili profesional (PËRSHKRIMI I DEGËS)

Cikli i dytë i studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” është vazhdim i ciklit të parë të studimeve Bachelor “Informatikë Biznesi”, i cili synon përgatitjen e specialistëve të rinj të aftë për shfrytëzimin efektiv të informacionit, teknologjisë dhe inovacionit në funksion të biznesit.

Ky program synon të ofrohet për të diplomuarit e rinj në Informatikë Ekonomike, Administrim Biznesi, Ekonomi, Informatikë etj, me synimin për të kuptuar dhe optimizuar ndërlidhjen e agrobiznesit në veçanti dhe biznesit në tërësi me Teknologjinë e Informacionit. Me fokus në menaxhimin e informacionit në funksion të biznesit synojmë të zhvillojmë aftësitë e studentëve në kuptimin e vlerës strategjike të informacionit në gjithë proceset e punës së biznesit nëpërmjet të mësuarit interaktiv, eksperiencave ndërkombëtare dhe internshipeve në kompani të ndryshme etj.

Në themel të këtij cikli studimesh qëndron nxitja, thellimi kërkimor, dhe kombinimi maksimal i zhvillimeve më të fundit dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe ligjeve ekonomike, të cilat japin më shumë mundësi për integrimin e të diplomuarve në tregun e punës. Studimi i trendeve ekonomike dhe atyre teknologjike, me fokusin maksimal ndaj kërkesave gjithnjë e më komplekse të tregut të punës, ndërtimi i modeleve analitike dhe zbatimi i tyre konkret është misioni kryesor i këtij programi.

Të diplomuarit në këtë program studimesh do të mund t’i përgjigjen mjaft mirë nevojave të tregut, veçanërisht sipërmarrjeve bujqësore, por jo vetëm, në drejtim të rritjes së efijencës së përdorimit të faktorëve të prodhimit dhe përsosjes së vendimmarrjes, drejtimit operacional, menaxhimit dhe monitorimit të gjithë hallkave të zhvillimit të biznesit.

Modulet kryesore të trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi:

a. Formim i përgjithshëm

1. Menaxhimi i Projekteve
2. Kërkimi dhe Analiza e Tregut

b. Formim baze karakterizues

1. Sisteme Përpunimi Informacioni
2. E-commerce dhe E-business
3. Inxhinieri Softuere
4. Programim i Avancuar në Web
5. Administrim Bazë të dhënash
6. Data mining
7. Siguria e Sistemeve të Informacionit

8. Sisteme të Shpërndara
9. Teoria e Vendimmarrjes
10. Aplikim Programesh

c. Formim integrues

1. Drejtimi i Rriskut të Biznesit
2. Hyrje në Kriptografi
3. Menaxhim Turizmi
4. Tregjet dhe Institucionet Financiare

Mundësitë për punësim

Programi Master Profesional në "Menaxhim Informacioni në Agrobiznes", synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në fushën e informatikës dhe në fushën e biznesit.

Ky program studimi ofron mundësi të mëdha karriere në pozicione si konsulent biznesi, analist biznesi, projektues dhe administrues i sistemeve të informacionit, menaxher IT në kompani vendase dhe të huaja, në sipërmarrje private apo institucione publike, krijim intraneti, mirëmbajtje rrjeti, instalime software aplikativë, analistë sistemesh të prirur nga biznesi, ndërtues faqesh webi, webmaster, etj.

Disa kompani ku studentët mund të punësohen janë:

- Administrata publike;
- Femrat Didaktike;
- Biznese private dhe sistemin bankar;
- Në të gjitha Industrinë e Agrobiznesit etj.

PROGRAMI MËSIMOR

Viti, Sem	Nr	Modulet	Kredite
Viti I, Semestri I (1)	1	Kërkim dhe Analiza e Tregut	5
	2	Sisteme Përpunimi Informacioni	5
	3	Siguria e Sistemeve të Informacionit	5
	4	Inxhinieri Software	5
	5	Tregje dhe Institucione Financiare	5
	Module me Zgjedhje 1		
6	<i>Biznes Ndërkombëtar</i> <i>Financa Ndërkombëtare</i>	5	
Viti I, Semestri II (2)	1	Menaxhim i Projekteve	5
	2	E-commerce dhe E-business	5
	3	Programimi Avancuar ne Web	5
	4	Drejtimi Rriskut të Biznesit	5
	5	Menaxhim Turizmi	5

	Module me Zgjedhje 2		
	6	<i>Menaxhim Strategjik</i>	5
	<i>Siguria në Rrjeta</i>		
Viti II, Semestri I (3)	1	Hyrje në Kriptografi	5
	2	Data Mining	5
	3	Sisteme të Shpërndara	5
	4	Administrim Bazë të Dhënash	5
	5	Teoria e Vendimmarrjes	5
	Module me Zgjedhje 3		
	6	<i>Programim Mobile</i>	5
	<i>Data Visualisation</i>		
Viti II, Semestri II (4)	1	Praktike Profesionale	12
	2	Teza e diplomës	18
		Totali i Krediteve	30
Totali i krediteve	1+2+3+4	120	